



**Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo**



**Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjilan
Gilan Belediyesi**

**RREGULLORJA
PËR
PUNËN E KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJILANIT**

Gjilan, nëntor 2008

Në bazë të nenit 12.2 pika b), 12.4 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 4 qershor 2008), Kuvendi i Komunës në Gjilan në mbledhjen e mbajtur më datën **21.11.2008**, miraton:

R R E G U L L O R E N **PËR PUNËN E KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJILANIT**

Dispozitat themelore

Lënda e rregullimit

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet puna dhe mënyra e funksionimit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

Definicionet/përkufizimet/

Neni 2

2.1. Termet që përdoren për nevoja të kësaj rregulloreje kanë domethënien si vijon:

“**Sekretaria e Kuvendit**” nënkupton shërbimin përkatës që ofron shërbime për Kuvendin e Komunës dhe trupave të tij.

“**Fjalë jo të matura**” nënkupton fjalët, qoftë të folura ose të shkruara të cilat përdoren në Kuvendin Komunës ose Komitetet e tij, e që janë:

- a) ofenduese, provokuese apo kërcënuese;
- b) sulmet apo ofendimet personale;
- c) gjuhë jo parlamentare;
- d) nxitë dhunën;
- e) nxitë dhunën gjinore;
- f) një akuzë e drejtpërdrejtë kundër një këshilltari të Kuvendit të Komunës ose drejtori të drejtorisë

“**Çështje e ngutshme**” nënkupton një çështje që është e ndërlidhur me një emergjencë të vërtetë, dhe e cila nuk mund të paraqitet para kuvendit me anë të mënyrave tjera dhe brenda një kohe të arsyeshme.

“**Projekt-rregullore**” është një propozim për rregullore i cili, përmes drejtorisë, komitetit përkatës dhe ekzekutivit i është dorëzuar kuvendit për debat dhe votim.

“**Grup i këshilltarëve**” nënkupton një grup të përbërë nga anëtarët e një partie, koalicioni ose iniciative qytetare, nga një numër i caktuar i anëtarëve të kuvendit të komunës që kanë minimum tre (3) anëtar, sipas përkufizimit në këtë rregullore, të cilët e kanë njoftuar kryesuesin e kuvendit të komunës për qëllimin e tyre të veprojnë si grup i këshilltarëve.

“**Javë pune**” nënkupton javën e punës në të cilën kuvendi mbanë mbledhje të rregullt, përveç javës Kuvendi mbledhet si pasojë e shqyrtimit të çështjeve të ngutshme edhe në ditët jo të punës.

“Ditë pune” nënkupton një ditë jave, nga e hëna deri të premten, përfshirë edhe këto të dyja, duke i përjashtuar festat publike, gjatë javës në të cilën kuvendi do të takohej normalisht.

Mbledhja Inauguruese

Neni 3

3.1. Kuvendi Komunës duhet ta mbajë mbledhjen e parë inauguruese brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

3.2. Mbledhja inauguruese e kuvendit të komunës, thirret nga kryetari i komunës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

3.3. Nëse kryetari i kuvendit të komunës nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës në paragrafin 2 të këtij neni, mbledhja inauguruese thirret nga anëtari më i vjetër i zgjedhur i kuvendit të komunës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data kur kryetari është dashur të thirr mbledhjen inauguruese të kuvendit të komunës.

3.4. Nëse anëtari më i vjetër i kuvendit nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës së tij në paragrafin 3 të këtij neni, mbledhja inauguruese e kuvendit të komunës caktohet me iniciativë të shumicës së anëtarëve të zgjedhur të kuvendit të komunës.

3.5. Mbledhjet e kuvendit të komunës, të cilat mbahen para zgjedhjes së kryesuesit të kuvendit të komunës, kryesohen nga anëtari më i moshuar i kuvendit të komunës, që është i pranishëm në mbledhje.

3.5. Kryesuesi i seancës kërkon nga Kryetari i Komunës dhe anëtarët e Kuvendit ta nënshkruajnë betimin apo deklaratën solemne.

3.6. Teksti i betimit për kryetarin e komunës është më sa vijon: **“Beto hem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej detyrat dhe do t’i ushtroj kompetencat e mia si kryetar i komunës së Gjilanit me nderë, besnikëri, paanshmëri, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të sigurohen kushte për një jetë të qetë për të gjithë”** Tekstin e betimit e lexon vetë kryetari.

3.7. Teksti i betimit për anëtarët e Kuvendit të Komunës është si vijon: **“Beto hem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nderë, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit, detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Gjilanit, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”**. Tekstin e betimit për anëtarët e Kuvendit të Komunës e lexon kryesuesi, kurse anëtarët japin betimin duke deklaruar betimin me fjalën “Beto hem“. Me atë rast secili nga anëtarët e nënshkruan tekstin e betimit.

3.8. Seancat e Kuvendit të Komunës kryesohen nga kryesuesi i Kuvendit të komunës ose në mungesë të tij nga zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës në rast se anëtarët e kuvendit të komunës nuk vendosin ndryshe. Në mungesë të kryesuesit të kuvendit të komunës dhe të zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës, seancën e udhëheqë shefi i grupit parlamentar që ka më së shumti ulëse në Kuvendin e Komunës.

3.9. Kuvendi i komunës është i obliguar të mbajë brenda vitit kalendarik së paku dhjetë (10) seanca në vit, pesë (5) prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë (6) muajve të parë të vitit siç përcaktohet me këtë rregullore dhe me ligj, me të drejtë të mbajtjes së seancave tjera sipas nevojës në pajtim me ligjin.

PUNA E KUVENDIT

Rendi në seancë

Neni 4

4.1. Kryetari, të emëruarit e tij, zyrtarët dhe personat tjerë që nuk janë anëtarët të Kuvendit, por që janë të pranishëm në seancën e Kuvendit të Komunës, do të lejohen nga ana e Kryesuesit të Kuvendit të komunës të flasin dhe t'i paraqesin qëndrimet dhe propozimet e tyre nëse kjo paraqitet si nevojë për të dhënë kontribut në seancë.

4.2. Kryesuesi i Kuvendit mund të urdhërojë një anëtar ose zyrtar , i cili sipas mendimit të tij ka përdorur fjalë jo të matura, të tërheq fjalët e tilla ose nëse është e nevojshme të ndërmarrë masa në pajtim me dispozitat kësaj rregulloreje.

4.3. Debat i ndonjë projekt - akti të përgjithshëm juridik ose të ndonjë propozimi tjetër përmbajtësor të shkruar, e të dorëzuar nëpërmjet kryetarit, të emëruarve të tij (drejtorët) ose komitetit përkatës, do të bëhet në pajtim me rendin si vijon:

- a. propozuesi i projekt-aktit të përgjithshëm ose të ndonjë propozimi tjetër përmbajtësor do të flasë i pari.
- b. në rast se propozuesi nuk është drejtor i drejtorisë, drejtori i drejtorisë do të ketë të drejtën të flasë i dyti.
- c. kryetari i komitetit funksional do të ketë të drejtën e radhës.
- d. kryetarët e komisioneve tjera.
- e. kryetarët e grupeve parlamentare do të kenë të drejtën, të flasin pasi të kenë fol kryetarët e komisioneve në pikat c) dhe d) të paragrafit 4.3 të këtij neni.
- f. anëtarët në kryesi të punës do të kenë të drejtë të flasin në çdo kohë pasi të ketë fol propozuesi dhe pasi të kenë përfunduar çdo paraqitje e ekzekutivit,
- g. të gjithë anëtarët tjerë do të kenë të drejtë të flasin mbi një projekt-akt të përgjithshëm ose propozim përmbajtësor sipas paraqitjes së tyre dhe rendit të përcaktuar nga kryesuesi i Kuvendit.
- h. në fund të debatit, propozuesi i projekt-aktit të përgjithshëm ose i ndonjë propozimi tjetër përmbajtësor do të ketë të drejtë të përgjigjet dhe pastaj Kryesuesi i Kuvendit përmbyll debatin.

4.4. Çdo anëtarë i Kuvendit ose drejtor që ka fol:

- a) ka të drejtë të reagojë ndaj fjalimit të një anëtari ose drejtori, që e ka përmendur emrin ose fjalimin e tij;
- b) e drejta për të reaguar sipas pikës (a) të paragrafit 4.3 të këtij neni, do të kufizohet në dy (2) minuta, menjëherë pas fjalimit përkatës;
- c) në rast kur një anëtar ose drejtor, përdor të drejtën për të reaguar sipas pikës (a) të paragrafit 4.3 të këtij neni, lejohet replika prej një (1) minute nga folësi i parë, menjëherë pas reagimit.

4.5. Pavarësisht nga parafi 4.3 dhe 4.4 të këtij neni, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës mund të lejojë anëtarin ose drejtorin të qartësojë diskutimin e mëhershëm, ose të japë shpjegime që do të ndihmonin debatin.

4.6. Një anëtar mund të flasë vetëm një herë gjatë rrjedhës së një debati, për një pikë të rendit të ditës, përveç në rastet si është paraparë në pikat 4.3, 4.4 dhe 4.5 të këtij neni.

4.7. Fjalimet në seancë të Kuvendit zgjasin më sa vijon:

- a) fjalimi i kryetarit të grupit parlamentar zgjatë më së tepërmi pesëmbëdhjetë (15) minuta,
- b) fjalimi i një anëtari zgjatë më së tepërmi pesë (5) minuta,
- c) prezantimi i komitetit përkatës funksional zgjatë më së tepërmi dhjetë (10) minuta,
- d) prezantimi i një Komisioni tjetër zgjatë më së tepërmi dhjetë (10) minuta,
- e) anëtarët mund të diskutojnë për rendin e ditës më së shumti dy (2) minuta,

Rregulli dhe sjellja në Kuvend

Neni 5

Anëtarët nuk duhet të ndërpresin fjalën e kryesuesit të seancës ose të diskutuesve të tjerë, të përdorin gjuhë ofenduese dhe jo adekuate në seancë të Kuvendit, të ndërmarrin sulme personale apo veprime ndaj ndonjë këshilltari, të përhapin informacione që cenojnë jetën private të cilitdo këshilltar, të sillen në mënyrë të padenjë ose të shkaktojnë rrëmujë në mjediset e Kuvendit të komunës.

Masat disiplinore

Neni 6

6.1. Masat disiplinore që zbatohen ndaj anëtarëve janë:

- a) tërheqje vëmendjeje;
- b) vërejtje;
- c) marrja e fjalës
- d) përjashtim nga seanca e kuvendit;
- e) përjashtim nga pjesëmarrja në komitete dhe komisione dhe në seancë të Kuvendit deri në 15 ditë.

Masa disiplinore e tërheqjes së vëmendjes dhe vërejtjes

Neni 7

7.1. Kur anëtari thotë fjalë të pahijshme, pengon me sjelljen e tij zhvillimin e seancës së Kuvendit ose cenon rregullin e saj, i tërhiqet vëmendja nga kryesuesi i seancës së kuvendit.

7.2. Në rast se anëtari, ndaj të cilit është zbatuar masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 7.1 të këtij neni, kërkon të japë shpjegime për veprimet e tij ose gjuhën e përdorur, fjala i jepet në përfundim të seancës së kuvendit të asaj dite për jo më shumë se 2 minuta.

7.3. Kur anëtari e përsërit shkeljen në të njëjtën seancë të kuvendit, pasi i është tërhequr një herë më parë vëmendja, ose këshilltari që cenon seriozisht rendin në seancë të kuvendit, i jepet vërejtje nga kryesuesi i seancës. Masa disiplinore e vërejtjes jepet nga kryesuesi i seancës së kuvendit të komunës për anëtarin në fjalë. Vërejtja regjistrohet në procesverbalin e përmbledhur të seancës së Kuvendit të Komunës dhe bëhet publike.

7.4. Nëse anëtari pas shqiptimit të vërejtjes vazhdon me sjelljet e tija apo me fjalim që nuk është në përputhje me rendin e ditës, i merret fjala.

7.5. Në rast se shprehjet ose fyerjet e bëra nga anëtari në seancë të kuvendit tërhiqen prej tij në po të njëjtën seancë dhe anëtari kërkon publikisht ndjesë për sjelljen e tij, masa disiplinore e dhënë në zbatim të paragrafit 7.3 të këtij neni, anulohet nga kryesuesi i seancës së Kuvendit të Komunës.

Masat disiplinore më të rënda

Neni 8

8.1. Kur anëtari përdor fjalë fyese ose cenon personalitetin e kryesuesit të seancës së kuvendit apo vazhdon të kryejë shkeljen, pasi më parë në të njëjtën seancë janë zbatuar masat disiplinore, sipas nenit 7 të kësaj Rregulloreje, me urdhër të kryesuesit të seancës, përjashtohet nga seanca e kuvendit për atë ditë. Në rast se anëtari s'pranon të dalë nga salla, kryesuesi i seancës së kuvendit e ndërpret atë dhe i jep porositë e nevojshme shërbimit të sigurisë në Kuvend, për zbatimin e urdhrit të dhënë.

8.2. Masa disiplinore e përjashtimit nga seanca e kuvendit, shoqërohet me sanksion financiar të barabartë me një ditë nga kompensimi për marrje pjesë në seancat e kuvendit të komunës.

8.3. Kur anëtari bën thirrje për përdorim dhune, provokon rrëmujë në seancë të kuvendit që pengon zhvillimin e saj të rregullt, fyen ose kërcënon anëtarët e tjerë, anëtarët e Bordit të drejtorëve ose përdor fjalë fyese për kryetarin e komunës apo institucione të tjera të komunës, ndalohet të marrë pjesë në punimet e Kuvendit dhe në komitetet e tij në seancën e ardhshme.

8.4. Ndalimi i pjesëmarrjes vendoset nga kryesia e punës së kuvendit me propozimin e kryesuesit të seancës së kuvendit.

8.5. Masa disiplinore e ndalimit të pjesëmarrjes në seancë të kuvendit dhe në komitete, shoqërohet me sanksion financiar të mbajtjes së kompensimit për anëtarin për aq seanca sa është marrë masa disiplinore.

8.6. Në rast se anëtari përpiqet të hyjë në sallën ku mbahet seanca e kuvendit ose të komiteteve apo komisioneve përpara mbarimit të kësaj mase ndëshkimore, afati i masës dyfishohet.

8.7. Për ngjarje tepër të rënda që ndodhin jashtë sallës ku zhvillohen punimet e Kuvendit, por brenda mjediseve të tij, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës merr masën disiplinore të parashikuar në pikën 8.2 të këtij neni.

8.8. Masat e parapara me lartë në këtë rregullore nuk aludojnë në çfarëdo përkufizimi në të shprehurit e mendimit të lirë.

Shtyrja, ndërprerja dhe përfundimi i seancës

Neni 9

9.1. Seanca e caktuar e Kuvendit shtyhet kur paraqiten shkaqet të cilat e pamundësojnë mbajtjen e saj në ditën e caktuar.

9.2. Seanca e Kuvendit shtyhet edhe kur pas hapjes konstatohet se në seancë nuk marrin pjesë një numër i mjaftueshëm i anëtarëve të Kuvendit për vendosje meritore.

9.3. Për shtyrjen e seancës së Kuvendit vendos kryesuesi i seancës së Kuvendit të Komunës.

Neni 10

10.1. Seanca e Kuvendit ndërpritet në rastet vijuese:

- a) me qëllim të pushimit gjatë seancës;
- b) kur gjatë seancës numri i anëtarëve të kuvendit bie nën numrin e paraparë për mbajtjen e seancës dhe vendosje meritore të paraparë sipas nenit 16.2 të kësaj rregulloreje.
- c) kur për shkak të qëndrimit të gjatë në seancë, e njëjta nuk mund të kryhet atë ditë dhe
- d) kur vjen gjerë te prishja e rëndë e rendit të ditës, por që kryesuesi nuk është në gjendje që me masa disiplinore të paraparë me nenin 8 të kësaj rregulloreje, nuk mund ta kthejë në gjendje normale pune.

10.2. Seanca e ndërprerë vazhdohet me të njëjtin rend pune të nesërmen, nëse nuk është ditë pushimi.

Neni 11

11.1. Seanca e Kuvendit konsiderohet e përfunduar pas shqyrtimit të kryer të rendit të ditës dhe vendosjes për të gjitha çështjet të cilat ishin në rend pune.

11.2. Kryesuesi me anëtarët e kryesisë së punës së kuvendit, mund të nxjerrë rregulla, përkritazi me pjesëmarrjen dhe sjelljen e publikut dhe të përfaqësuesve të mediave që ndjekin seancat e kuvendit. Kryesuesi i kuvendit të komunës, kërkon nga të gjithë personat që nuk i respektojnë rregullat e tilla, të largohen nga seanca e Kuvendit.

Përcaktimi i rendit të ditës

Neni 12

12.1. Në fund të çdo seance, kryesuesi i seancës së kuvendit të komunës, ndonjë grup i këshilltarëve ose ndonjëri nga këshilltarët mund të propozojë ndonjë pikë për t'u diskutuar në seancën e ardhshme të kuvendit, në rast se një gjë e tillë nuk kundërshtohet nga shumica e këshilltarëve në seancë.

12.2. Kryesuesi i kuvendit të komunës, paraprakisht konsultohet me kryetarin e komunës,

kryetarët e grupeve parlamentare, komitetin për politikë dhe financa, për caktimin e rendit të ditës të seancave të kuvendit të Komunës. Kryesuesi i kuvendit, po ashtu konsultohet edhe për çështjet e orarit të ditës. Me nismën e vet, ose si përgjigje ndaj kërkesës së kryetarit të komunës, ose nga një apo më shumë grupe parlamentare, që përfaqësojnë jo më pakë se një të **tretën (1/3)** e anëtarëve në Kuvend, kryesuesi thërret seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit, në mënyrë që të trajtojë një apo më shumë çështje urgjente. Kërkesa për mbledhje të jashtëzakonshme, duhet të përmbajë çështjen ose çështjet që parashtruesi i kërkesës dëshiron të shqyrtohen në Kuvend. Në rast të këtillë, Kuvendi shqyrton vetëm çështjet që janë ngritur me kërkesën për mbledhjen e jashtëzakonshme.

12.3. Pikat e caktuara në rendin e ditës për seancën e jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë seancës.

Parashtrimi i pyetjeve për (kryetarin e Komunës dhe për drejtorë) dhe përgjigjet me gojë

Neni 13

13.1. Secili anëtar i kuvendit ka të drejtë të parashtojë pyetje lidhur me punën e kryetarit të komunës ose të drejtorisë përkatëse.

13.2. Në Seancat e Kuvendit të komunës, për përgjigjet e dhëna në pyetjet e bëra parashihet koha:

- a) që kryetari ose drejtori i drejtorisë përkatëse t`iu përgjigjet pyetjeve me gojë më së shumti 10 minuta, në mbledhje.
- b) pyetjet për përgjigjet me gojë duhet t`i dorëzohen të paktën pesë (5) ditë pune, por jo më shumë se dhjetë (10) ditë pune, para kohës kur duhet përgjigjur në to. Asnjë anëtarë i kuvendit të komunës nuk mund t`i parashtojë pyetje kryetarit të komunës ose ndonjë drejtorit të caktuar më shumë se dy pyetje, për përgjigje me gojë në cilën do ditë. Pyetjet duhet të jenë lidhur me përgjegjësinë e kryetarit ose drejtorit në fjalë.
- c) kryesuesi i seancës së Kuvendit të komunës përcakton, nëse një pyetje është e pranueshme, duke pasur parasysh Rregulloren e ditës. Nëse një pyetje refuzohet, anëtari që e ka propozuar pyetjen duhet t`i jepet një shpjegim me shkrim. Pyetjet e pranuar do të përfshihen në rendin e ditës të seancës, në të cilën do të jepen përgjigjet.
- d) pyetjet që i bëhen kryetarit ose ndonjë drejtorit marrin përgjigje sipas rendit të parashtrimit të tyre.
- e) kryesuesi i Kuvendit të Komunës do të lejojë anëtarin, që pas përgjigjes së kryetarit ose të drejtorit, të bëjë menjëherë edhe pyetje shtesë. Parashtrimi i pyetjes, dhënia e përgjigjes, parashtrimi i pyetjes shtesë dhe përgjigja në të, nuk mund të zgjasin më tepër se pesë (5) minuta.
- f) në rast kur ndonjë pyetje për përgjigje me gojë, nuk merr përgjigje brenda kohës së lejuar, anëtari mundësisht do të merr përgjigje me shkrim në të njëjtën ditë. Në rast se edhe kjo nuk mund të bëhet në të njëjtën ditë të merr përgjigje me shkrim, sa më shpejtë që është e mundur por jo më vonë se dy (2) ditë nga data e parashtrimit të pyetjes në fjalë.
- g) në çdo seancë të Kuvendit të komunës, kryetari ose një drejtor, me pajtimin e Kryesuesit të Kuvendit, mund të flasë para Kuvendit lidhur me ndonjë çështje që ka të bëjë me fushë veprimtarinë e përgjegjësive të tij. Kryetari ose drejtori që dëshiron të flasë duhet të merret vesh paraprakisht me kryesuesin e kuvendit, për kohën e fjalimit të tij, i cili nuk duhet të jetë në asnjë rast më i gjatë se dhjetë minuta. Pas mbajtjes së fjalimit, Kryesuesi i kuvendit, lejon parashtrimin e vërejtjeve ose të pyetjeve në emër të grupeve

parlamentare, aq sa lejon koha, e po ashtu edhe nga anëtarët e Kuvendit individualisht. Kryetari ose drejtori që ka mbajtur fjalimin, ka të drejtë të përgjigjet shkurtimisht në çdo vërejtje ose pyetje që mund të parashtrahet.

Çështjet e ngutshme

Neni 14

Në të gjitha seancat e Kuvendit të komunës, çdo grup parlamentar ose këshilltar që paraprakisht e ka marrë lejen e Kryesuesit të kuvendit, mund të propozojë që kuvendi, menjëherë të marrë parasysh një çështje të ngutshme me interes të veçantë publik, e cila është paraqitur në kohën midis dy seancave të Kuvendit. Nëse kryesuesi i kuvendit së bashku me kryesinë e punës konsideron se çështja meriton vëmendjen e menjëhershme të kuvendit, ai do të lejojë grupin ose anëtarin në fjalë që të arsyetojë propozimin e tij në Kuvend dhe pastaj do të vë në votim atë çështje. Përgjigjet kur propozimi i bërë nuk është bërë nga kryetari ose një drejtor, atëherë kryetari ose drejtori përkatës do t'i lejojë të paraqes pikëpamjet e veta para se të votohet. Nëse Kuvendi vendos të marrë parasysh çështjen, atëherë duhet ta bëjë një gjë të tillë gjatë takimit.

Propozimet procedurale

Neni 15

15.1. Në mbledhje të Kuvendit të komunës, kryetarët e grupeve parlamentare ose anëtarët, mund të propozojë cilëndo nga propozimet në vijim:

- a) propozimi për të shtyrë seancën;
- b) propozimi për të shtyrë debatin për ndonjë pikë të rendit të ditës,
- c) propozimi për plotësim të rendit të ditës, bartjen e ndonjë çështje ndonjë komiteti apo komisioni,
- d) propozimi për të përfunduar debatin,
- e) propozimi për të sfiduar Rregulloren e punës, nëse nuk aplikohet si duhet,
- f) propozimi për të sfiduar nëse janë shkelur të drejtat e një këshilltari, të përcaktuara me këtë Rregullore

15.2. Lidhur me pikën a) dhe b), mbahet votimi i menjëhershëm, pa debat.

15.3. Lidhur me pikën c) Kuvendi i Komunës, duhet të zhvilloi debat për të arsyetuar bartjen.

15.4. Lidhur me pikën d), do të debatohet menjëherë në përputhje me këtë Rregullore. Për derisa të mos votohet për këtë propozim, nuk do të merret parasysh asnjë propozim tjetër përpos propozimit në bazë të pikës a) dhe b).

15.5. Lidhur me pikën e), Kryesuesi i kuvendit, do të ndërmarrë masa që të tërheqë vërejtjen, që puna në seancë të zhvillohet sipas rregullores së punës.

15.6. Lidhur me pikën f), Kryesuesi i kuvendit, shqyrton propozimin dhe brenda seancës ose në seancën e ardhshme të Kuvendit, do t'i raportojë Kuvendit se a janë shkelur të drejtat e anëtarit. Nëse janë shkelur të drejtat e anëtarit të Kuvendit, kryesuesi do të sugjeroi anëtarin e kuvendit që të korrigjoi veprimet e tija në të ardhmen.

Kuorumi dhe Votimi

Neni 16

16.1. Kuorumi për të gjitha Seancat e Kuvendit të komunës është i vlefshëm, nëse gjysma e anëtarëve të kuvendit janë të pranishëm në mbledhje, me të drejtë pjesëmarrje dhe votimi.

16.2. Seancat e Kuvendit ndërpriten, nëse numri i anëtarëve të pranishëm në sallë bie nën një të dytën (1/2) e numrit të përgjithshëm.

16.3. Vendimet e Kuvendit të komunës merren me votimin të thjeshtë të shumicës së Anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë “për” ose “kundër”, përveç në rastet kur me këtë Rregullore të punës parashihet shprehimisht ndonjë kërkesë tjetër votimi.

16.4. Votimi bëhet përmes njërës prej mënyrave në vijim:

- a) votimi i thjeshtë “për” – “kundër” – “abstenim” me ngritje dore;
- b) përmes votimit të regjistruar:
 - thirrjen e secilit anëtar veç e veç ose
 - votimi elektronik nëse ekziston.
- c) votimi i regjistruar, bëhet në rast kur këtë e kërkon kryesuesi i kuvendit ose një grup parlamentar. Në rastet kur mbahet votimi i regjistruar, vota e secilit anëtar “për”, ose “kundër”, do të regjistrohet me emër.
- d) votimi elektronik, mund të zbatohet nëse ekzistojnë pajisjet e nevojshme elektronike;
- e) votim të fshehtë, i cili bëhet në fletëvotime të cilat duhet të jenë pa tjetër të madhësisë, ngjyrës dhe formës së njëjtë. Votimi i fshehtë mund të vjen në shprehje vetëm për çështje të caktuara. Për votim të fshehtë Kuvendi i komunës vendos me vendim paraprak. Procedurën e votimit e cakton dhe zbaton kryesuesi i kuvendit si kryesues i seancës me anëtarët tjerë të kryesisë së punës.

16.5. Në rast të numrit të barabartë të votave të hedhura “për” dhe “kundër” ndonjë propozimi, kryesuesi i kuvendit e ka një votë shtesë në rast të numrit të njëjtë të votave.

Nënshkrimi i akteve të miratuara nga Kuvendi

Neni 17

Aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës, hyjnë në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe nënshkrimin të tyre nga kryesuesi i kuvendit . Kryesuesi i kuvendit brenda 48 orësh i nënshkruan aktet e miratuara nga Kuvendit i Komunës.

Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të Kuvendit komunal

Neni 18

18.1. Të gjithë anëtarët e Kuvendit kanë të drejta të njëjta dhe të barabarta dhe mundësi për të marrë plotësisht pjesë në proceset e kuvendit pa marrë parasysh përkatësinë e tyre kombëtare, racën, ngjyrën, gjininë, fenë, mendimin politik ose ndonjë dallim tjetër.

18.2. Çdo anëtarë i kuvendit detyrohet që të marrë pjesë në të gjitha seancat e Kuvendit duke u përgatitur për seancë dhe duke parashtruar mendimin e vetë lidhur me çështjet që janë në rend të ditës. Po ashtu çdo anëtar duhet që gjithëherë ta njoftojë kryesuesin e seancës së Kuvendit për pamundësinë e ardhjes së tij në seancë dhe arsyet për mosardhjen e tij të konstatohen në procesverbal.

18.3. Kuvendi i Komunës do të tregojë transparencë për sugjerimet që vijnë nga përfaqësuesit e minoritarëve që jetojnë në Komunën e Gjilanit dhe me kujdes ato do t'i marrë në konsideratë.

18.4. Kuvendi i Komunës do t'ua lehtësojë pjesëmarrjen aktive të këshilltarëve me aftësi të kufizuara dhe do të sigurojë çfarëdo ndihme teknike për këtë qëllim.

18.5. Kuvendi i Komunës do të inkurajojë pjesëmarrjen aktive të anëtarëve femra dhe të sigurojë se zëri i tyre do të dëgjohet plotësisht duke e marrë parasysh para, gjatë dhe pas mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

18.6. Inkurajimi për pjesëmarrjen aktive në punën e Kuvendit komunës dhe në sigurimin e të drejtave për minoritete, femra dhe për persona me aftësi të kufizuara, nuk do të konsiderohen si diskriminim i kundërt ndaj përfaqësuesve të shumicës.

Konflikti i Interesit

Neni 19

19.1. Anëtari i komitetit dhe anëtari i komisionit, nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative, që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i familjes së tij apo saj, ka interes personal dhe material.

19.2. Përgjashtimisht nga neni 19.1 nga procedurat e marrjes së vendimeve të anëtarëve të Kuvendit, anëtarëve të komiteteve dhe komisioneve, mund të bëhet me tërheqjen e tyre vullnetare ose me vendim të shumicës së atij kuorumi ose me kërkesë të palës së tretë, ku kërkesa e parashtruar gjithëherë duhet të jetë e argumentuar në prova materiale lidhur me çështjen konkrete e cila është objekt i vendosjes dhe paraqitet konflikti i interesit.

19.3. Në rast se ekziston konflikti i interesit dhe gjatë procedurës vendim – marrjes, i njëjti nuk është vërejtur apo anëtari i Kuvendit, i Komitetit apo komisionit nuk e ka paraqitur atë, atëherë organi që ka marrë vendim e anulon të njëjtin dhe vendos rishtas për çështjen konkrete e cila ka qenë objekt i shqyrtimit.

Gjuhët e përdorura në Kuvend dhe në dokumente

Neni 20

20.1. Seancat e kuvendit të komunës mbahen në gjuhën shqipe dhe serbe, duke siguruar përkthimin adekuat, sipas nevojës.

20.2. Shërbimet e përkthimit gjithashtu do të sigurohen edhe në gjuhët tjera minoritare, përveç në shqip dhe serbisht në rast se anëtarët e Kuvendit që flasin ato gjuhë marrin pjesë në Seancat e Kuvendit dhe që të njëjtit paraprakisht kanë kërkuar shërbime të tilla.

20.3. Të gjitha dokumentet zyrtare të Kuvendit shkruhen në gjuhën shqipe dhe serbe, sipas nevojës edhe në gjuhën e komunitetit të cilit i referohet dokumenti.

Sekretaria e Kuvendit

Neni 21.

21.1. Sekretaria e Kuvendit është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve profesionale, administrative dhe teknike për nevojat e Kuvendit, grupeve të këshilltarëve dhe të anëtarëve të Kuvendit.

21.2. Materiali për mbledhjet e rregullta të Kuvendit, duhet të dërgohet shtatë (7) ditë para mbajtjes së mbledhjes, ndërsa tri (3) ditë përpara për mbledhje të jashtëzakonshme, nëpërmjet formave të komunikimit zyrtar.

21.2. Punët e sekretarisë i udhëheq zyrtari i autorizuar.

Ndryshimi i rregullores së punës së Kuvendit

Neni 22

22.1 Kryesuesi e shqyrton vazhdimisht Rregulloren e punës dhe në bazë të nevojës mund t'i propozojë Kuvendit ndryshime, të cilat mendon se janë të nevojshme.

22.2. Propozimin për ndryshimin e Rregullores mund ta iniciojë çdo grup parlamentar, anëtar i kuvendit të mbështetur nga së paku e 1/3 e anëtarëve të kuvendit.

22.3. Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës e merr Kuvendi, me shumicën e anëtarëve të kuvendit.

Dispozitat kalimtare

Hyrja e rregullores në fuqi

Neni 23.

Kjo rregullore e punës, hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi dhe nënshkrimit të saj nga kryesuesi i kuvendit. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, pushojnë të vlejshme dispozitat e

Rregullores paraprake për Punën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 3737 e datës 16.04.2008.

Rreg. 01. nr. 12480
Gjilan, 21.11.2008

Kryesuesi i Kuvendit

/ Bujar Nevzati/